

UDHËZIM
Nr. 4, datë 16.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË TURIZMIT DHE
MJEDISIT NR. 1, DATË 6.5.2019, “PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS SË NDARJES SË
KUOTAVE VJETORE TË IMPORTIT TË SUBSTANCAVE TË KONTROLLUARA”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 35 dhe nenit 70 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, dhe të pikës 1, të kreut VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 9.1.2019, “Për miratimin e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve e të pajisjeve që përmbajnë këto substanca”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 6.5.2019, “Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, togfjalëshi “*që aplikojnë në Ministri*” zëvendësohet me togfjalëshin “*që aplikojnë nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania*”.

2. Pika 3, ndryshon si më poshtë: “3. *Aplikimi për kuotë vjetore importi bëhet 1 (një) herë në vit nga subjektet e interesuara nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania. Afati për kryerjen e aplikimeve fillon nga data 5 janar dhe përfundon në datën 5 shkurt të çdo viti kalendarik*”

3. Në pikën 6, togfjalëshi “*dubët të dorëzojnë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*ngarkojnë nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania*”.

4. Pika 6, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6. Kërkesa për t’u pajisur me autorizim për çdo sasi që importojnë brenda kuotës vjetore për substancat ozonholluese bëhet *nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania* dhe aplikuesi ngarkon dokumentet si më poshtë:

a) formularin e plotësuar të njoftimit të importit të substancave të kontrolluara, sipas shtojcës 8, të VKM-së 10/2019;

b) vetëdeklarimin lidhur me përmbushjen e detyrimeve të raportimit sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 10/2019”;

5. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

“6/1. *Ministria është përgjegjëse për sigurimin e dokumentit të licencës “Për importin e substancave ozonholluese”, kodi III.3 dhe dokumentit të raportimit të dorëzuar pranë ministrisë dhe Njesisë Kombëtare të Ozonit.*”

6. Pika 7, ndryshohet si më poshtë:

“7. *Afati i shqyrtimit të dokumentacionit për dhënien e autorizimit është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e marrjes së kërkesës. Ministria mund t’i kërkojë subjektit aplikues, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, plotësim të dokumentacionit.*”

7. Në pikën 8, fjalia “*Afati 5-ditor për plotësim dokumentacioni nuk përlllogaritet në fatin prej 20 (njëzet) ditësh*”, shfuqizohet.

8. Në pikën 10, togfjalëshi “*5(pesë) ditëve pune*” zëvendësohet me togfjalëshin “*3 (tri) ditëve pune*”.

9. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Drejtoria përgjegjëse e politikave në fushën e substancave ozonholluese, shqyrton aplikimin dhe mendimin e NJKO-së dhe barton aktin e miratimit/refuzimit të kërkesës brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të afatit të aplikimit.

Akti i miratimit/refuzimit gjenerohet elektronikisht me vule elektronike ose nënshkrim elektronik të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe postohet në llogarinë e aplikantit në portalin e-Albania”.

10. Në pikën 13, togfjalëshi “10 ditëve kalendarike pas mbarimit të afatit 3-mujor” zëvendësohet me togfjalëshin “3 muajve nga data e lëshimit të autorizimit për kuotën vjetore të importit”. Pas togfjalëshit “dubet të njoftojë” shtohet togfjalëshi “nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania”.

11. Në pikën 15, togfjalëshi “krijon dhe mban regjistrin”, zëvendësohet me togfjalëshin “mban të dhënat në format elektronik”.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet drejtoria përgjegjëse e politikave në fushën e substancave ozonholluese në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

13. Procedurat e aplikimit sipas udhëzimit të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 1, datë 6.5.2019, “Për përcaktimin e mënyrës së ndarjes së kuotave vjetore të importit të substancave të kontrolluara”, të ndryshuar, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania, zbatohet në momentin që Sistemi i Integruar Mjedisor do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës për pajisje kuote vjetore importi të substancave ozonholluese dhe dokumentacionit të përcaktuar në pikën 6, bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi